STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 8 prill 2013

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON GJITHË PARQET SHTETËRORE DHE PLAZHET E LONG ISLAND TË HAPEN SIPAS PARASHIKIMIT NË PRAG TË DITËS PËRKUJTIMORE (MEMORIAL DAY)

Shumë nga parqet shtetërore dhe plazhet e Long Island pësuan dëme nga super stuhia Sandy

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se gjithë parqet shtetërore dhe plazhet e Long Island pritet të hapen fundjavën e Ditës Përkujtimore (Memorial Day). Për shkak të super stuhisë Sandy, shumë nga parqet pësuan dëmtime të shumta të rrugëve, peizazhit dhe infrastrukturës ndërsa plazhet pësuan gërryerje të konsiderueshme të dunave ranore dhe bregdetit, përfshi humbje të bimësisë natyrore dhe vendase. Projekte të shumta ndërtimore dhe riparuese po zbatohen sipas planifikimit gjë që dot ë bëjë të mundur hapjen e parqeve dhe plazheve në fundjavën e festës.

“Me gjithë shkatërrimin e madh të shkaktuar nga super stuhia Sandy, gjithë parqet shtetërore dhe plazhet e Long Island pritet të hapen për njujorkezët dhe vizitorët në fundjavën e Ditës Përkujtimore (Memorial Day)”, tha Guvernatori Cuomo. “Parqet dhe plazhet tona jo vetëm se janë shumë të frekuentuar nga pushuesit, por ato janë edhe motorë të rëndësishëm të lëvizjes së ekonomisë në komunitetet tona. Ne do të vazhdojmë të punojmë pa u lodhur për të kthyer kushtet e mira dhe sigurinë në këto asete të mëdha me qëllim që vizitorët t'i gëzojnë këtë verë”.

Aktualisht, mbi 20 kontrata emergjente po zbatohen në gjithë Long Island në lidhje me parqet shtetërorë ku qindra punëtorë po punojnë për të riparuar, rimbjellë dhe restauruar dëmet e lëna nga Sandy në përpjekje për të plotësuar nevojat e popullsisë gjatë fundjavës së Ditës Përkujtimore, fillimi jo zyrtar i stinës së verës.

“Parqet dhe plazhet tona në Long Island janë vend prehjeje për të cilën kanë nevojë njerëzit. Sandy shkaktoi shumë shkatërrime por ekipet dhe kontraktorët tanë po punojnë pa u lodhur për të na krijuar kushtet për fillimin e verës”, thotë komisionerja e Parqeve Shtetërore (State Park) Rose Harvey. “Kur numri i njerëzve që vizitojnë çdo vit atraksionet tona siç është Parku Shtetëror i Jones Beach është më i madh se i atyre që vizitojnë Grand Canyon, kuptohet sa të rëndësishme janë qendrat tona në jetën e njerëzve”.

Më 2012, më tepër se 18 milion njerëz vizituan parqet shtetërore dhe plazhet në Long Island. Vitin e kaluar, katër parqe shtetërore në Long Island u radhitën ndër dhjetë plazhet më të frekuentuar në të gjithë sistemin e parqeve shtetërore të Nju Jorkut 179 (179 New York State Parks) (#2 Jones Beach State Park, #4 Robert Moses State Park, #6 Sunken Meadow State Park dhe #10 Heckscher State Park).

Sipas studimit më të fundit të kryer nga Instituti i Kërkimeve të Ekonomisë Politike të Universitetit të Masaçusetsit, vizitorët në parqet shtetërore sigurojnë deri në 1.9 miliard dollarë të ardhura nga shitjet çdo vit. Nga të 1.9 miliard dollarët, rajoni i Long Island siguron totalin e dytë më të lartë, duke sjellë mbi 410 milion dollarë të ardhura në vit. Afro 40% i kësaj shifre totale i përket njerëzve që vijnë nga jashtë komunitetit për të vizituar parqet dhe që shpenzojnë në transport, strehim, ushqime, restorante dhe dyqane të tjera.

Ekzekutivi i komunës Nassau Edward P. Mangano thotë, “Unë e përgëzoj Guvernatorin Cuomo për përpjekjet e tij për riparimin dhe rehabilitimin e parqeve , plazheve dhe rrugëve tona me qëllim që ato të jenë të hapura për punë në fundjavën e Ditës Përkujtimore (Memorial Day). Ne po punojmë së bashku në këtë periudhë pas uraganit Sandy për të rindërtuar komunën e Nassau për banorët, bizneset dhe vizitorët”.

Ekzekutivi i komunës të Suffolk Steve Bellone thotë, “Plazhet dhe parqet e Long Island janë jetike për cilësinë e jetës dhe ekonomisë sonë. Ky është një lajm shumë i mirë për dhjetëra mijëra vende pune që ekzistojnë falë ekonomisë bregdetare dhe miliona njerëzve që vizitojnë plazhet e parqet tona të cilësisë botërore”.

Më poshtë vijon një raport për gjendjen e disa nga parqeve dhe plazheve shtetërore të frekuentuar në Long Island, përfshi punën që po kryhet apo ka përfunduar si dhe situatën që pritet në fundjavën e Ditës Përkujtimore (Memorial Day).

Parku shtetëror Bayard Cutting Arboretum
Gjendja aktuale: Pemët e parkut pësuan dëme të konsiderueshme; megjithatë ai është vënë plotësisht në funksionim pa kufizime. Aneksi (Annex) ka pasur dëmtime të çatisë por ato janë riparuar.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Trungjet e pemëve dhe mbeturinat ende do të jenë të grumbulluara dhe një kontraktor i pemëve do të punojë në park gjatë verës.

Parku shtetëror Belmont Lake
Gjendja aktuale: Vazhdon puna për riparimin e pemëve, pastrimin, grirjen e cungjeve dhe riparimin e gardhit rrethues të parkut. Mbeturinat nga stuhia po grumbullohen në përgatitjen për tu hequr prej andej nga kontraktorët.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për riparimin e pemëve dhe gardhit.

Parku shtetëror Bethpage

Gjendja aktuale: Të gjitha mjediset brenda parkut shtetëror Bethpage që janë planifikuar për tu hapur, janë hapur. Po vazhdon heqja e pemëve por mjediset që normalisht janë të mbyllura në këtë periudhë të vitit, do të hapen sipas parashikimit.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Puna me pemët do të përfundojë.

Parku shtetëror Brentwood

Gjendja aktuale: Riparimi i gardhit do të vazhdojë.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për riparimin e gardhit.

Rezervati i parkut shtetëror Caleb Smith

Gjendja aktuale: Katër nga urat prej druri për këmbësorët u dëmtuan dhe duhet të zëvendësohen në anën jugore të parkut. Shumë nga shtigjet janë pastruar në zonat ku bëhet peshkimi. Kontraktori duhet të përfundojë pastrimin e pemëve dhe heqjen e pemëve të rrezikshme.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë zëvendësimi i urave dhe pastrimi i pemëve.

Parku shtetëror Captree

Gjendja aktuale: Kalata Overlook (Pier) ishte duke u riparuar nga uragani Irene, ndërsa Sandy shkaktoi vetëm disa dëme të tjera të vogla. Punonjësit e parkut po vazhdojnë të ndërtojnë kalatën e dëmtuar. Kalata kryesore e peshkimit (Main Fishing Pier) u propozua për riparime të cilat po vazhdojnë nëpërmjet një kontrate që filloi përpara se Sandy të godiste parkun. Riparimet e çatisë do të përfundojnë nëpërmjet një kontrate emergjence. Të gjitha mbeturinat nga stuhia janë larguar nga parku. Pilotat në marinën kryesore janë zëvendësuar. Platformat pluskuese të nisjes të Captree janë hequr nga gjiri dhe shumica e tyre janë riparuar nga stafi i parkut.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për riparimin. Overlook Pier do të përfundojë.

Rezervati i parkut historik shtetëror Caumsett

Gjendja aktuale: Caumsett pësoi gërryerje të konsiderueshme përgjatë bregdetit prej 2.5 milje përgjatë Long Island Sound përfshi humbje të lartësisë dhe thellësisë së bregdetit. Qindra metra kub mbeturina dolën në breg dhe në kënetën Salt Marsh. Kontraktorët aktualisht po pastrojnë mbeturinat në breg përpara stinës së Piping Plover. Rruga me dërrasa që çon nga parkingu Fisherman te Lloyd Point është dëmtuar për rreth 0.2 milje për shkak të gërryerjes nga LI Sound deri në Salt Marsh. Mbi 285 pemë u dëmtuan apo u shkatërruan përgjatë rrugëve dhe shtigjeve të parkut që tani janë pastruar. Dy çati xhami i kishte marrë era në ndërtesën historike Bottling në kompleksin Dairy Complex, por ato janë zëvendësuar. Një pemë kishte dëmtuar fasadën e Polo Pony Barn por stalla është riparuar.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Heqja e mbeturinave do të përfundojë dhe pemët e dëmtuara do të largohen. Riparimet e rrugës prej dërrase (Plank Road) do të vazhdojnë.

Rezervati i parkut shtetëror Connetquot

Gjendja aktuale: Connetquot pati dëme strukturore minimale. Dëmi i vetëm ishte dera prej teli e

ndërtesës administrative si dhe pjesët e mëposhtme në ndërtesën kryesore (Main House): një oxhak u rrëzua (ende ka nevojë për tu riparuar), tullat thyen një nga çatitë e xhamit (është riparuar), ka dëmtime të tjera të çatisë (planifikuar për tu zëvendësuar). Nuk pati dëme të mëdha.. Nevojiten të pastrohen disa pemë dhe mbeturina.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për pastrimin.

Plazhet Gilgo dhe Tobay
Gjendja aktuale: Të dy plazhet pësuan gërryerje të rënda të dunave dhe humbje të bimësisë. Punëtorët po rindërtojnë dunat dhe po rimbjellin më tepër se një milion bimë të barërave që rriten në plazhet amerikane (vegjetacion vendas).
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR

Parku shtetëror Heckscher
Gjendja aktuale: Në plazhin West Beach pati gërryerje të konsiderueshme. Është dhënë një kontratë për të pasuruar bregdetin me rreth 2500 metër kub rërë. Në Field 7 pati gërryerje të rëndësishme dhe pati dëme të konsiderueshme të rrugës për biçikleta dhe parkingut. Një konsulent është ngarkuar me ridizenjimin e parkingut larg nga bregu. Sportet ujore mund të vendosen në plazhet për not deri sa të fillojë stina e notit. Valët nga stuhia dëmtuan transformatorin dhe siguresat në Overlook Beach. Një kontraktor është ngarkuar me punën riparuese.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: Plazhi West Beach do të jetë plotësisht i HAPUR. Rruga për biçikleta në Field 7 do të zhvendoset përkohësisht dhe do të sigurohen sportet ujore. Ridizenjimi dhe ndryshimet e mjedisit do të vazhdojnë.

Parku shtetëror Hempstead Lake
Gjendja aktuale: Parku humbi afërsisht 400 pemë. Fusha e parkingut #1 është rihapur.
Nja nga ndërtesat pësoi dëme të vogla, por u riparua menjëherë pas stuhisë.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR– Puna me pemët do të përfundojë ndërsa ndërtesa u riparua.

Parku shtetëror Jones Beach
Gjendja aktuale: Parku shtetëror Jones Beach pësoi dëme të konsiderueshme nga Sandy. Valët e shkaktuara nga stuhia u lartësuan nga batica dhe zhytën pjesë të mëdha të parkut nën ujë. Shëtitorja e famshme buzë ujit pësoi dëme të mëdha kur batica shtrembëroi pilotat, duke e ngritur lart një pjesë të shëtitores gjë që solli valëzimin e saj. Pilotat janë vendosur përsëri, në Central Mall u vendosën pilota shtesë, ndërsa platforma është riparuar. Shumë nga kabinat elektrike u zhytën dhe po vazhdon puna për të zëvendësuar dhe ngritur panelet për të parandaluar dëmet nga stuhitë në të ardhmen. Energjia është rikthyer në West End, West Bathhouse, dhe Jones Beach Theater. Puna në Box Office pothuajse ka përfunduar dhe parqet shtetërore do të lëshojnë certifikatën e zotërimit për atë strukturë. Pritet që zonat e tjera që kanë mbetur do të kthehen në normalitet së shpejti pasi kontraktorët vazhdojnë të bëjnë riparime. Jones Beach Theater u zhyt nën të paktën katër këmbë ujë i cili dëmtoi shëtitoren VIP si dhe zonat e mbuluara, të gjithë sistemin elektrik të ngrehinës. Të gjitha pajisjet dhe furnizimet, zyrat dhe kabina e biletave u shkatërruan. Kompania licencuese aktualisht po zëvendëson dhe riparon mjedisin me

qëllim që ai të jetë gati për stinën e koncerteve 2013. Kalatat e peshkimit Field 10 si dhe doku i basenit të varkave u dëmtuan rëndë e po kështu edhe koncesioni i operuar nga Bait Station. Nga parku janë larguar shumë tonelata me mbeturina. Pikat e vrojtimit të Lifeguard dhe stendat e çadrave u shkatërruan. Kontraktorët kanë filluar punën në pikat e vrojtimit të lifeguard në Central Mall dhe Field 2. Kontraktori do të çojë më shumë staf për të përfunduar të gjitha ndërtesat. Rrugët me tulla, ato me beton dhe pjesa lindore e parkingut Field 6 u dëmtuan rëndë. Është siguruar një kontraktor dhe ka filluar puna riparuese. Parku (fields 2, 6, 10 dhe West End 2) është tashmë i hapur për publikun. Zonat midis West Bathhouse dhe East Bathhouse janë mbyllur kryesisht për shkak të dëmtimit të shëtitores si dhe ndërtimeve.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR– Shëtitorja Jones Beach do të vihet në përdorim. Do të ketë zona me parmakë të përkohshëm deri sa të vijnë materialet. State Parks ishte faza e fundit e zëvendësimit të platformës së shëtitores në anën perëndimore të parkut në Fields 1 dhe 2 përpara stuhisë. Kjo kontratë do të vazhdojë gjatë gjithë sezonit. Pajisjet dhe kabinat elektrike do të zëvendësohen. Pritet që kjo punë të përfundojë para fundjavës së Ditës Përkujtimore; megjithatë, në rast se kabinat nuk do të kenë përfunduar, ato do të funksionojnë me gjenerator.

Riparimet në kalatat e peshkimit Field #10 dhe Boat Basin do të vazhdojë. Pikat e vrojtimit të lifeguard si dhe stendat e çadrave do të jenë duke u ndërtuar, disa do të përfundojnë përpara fundjavës së Ditës Përkujtimore. Do të hapen trailera të përkohshëm në ato vende ku ndërtesat e reja nuk kanë përfunduar ende.

Parku shtetëror Orient Beach

Gjendja aktuale: Parku shtetëror Orient Beach mbetet ende i mbyllur pas Sandy. 2 milje përgjatë hyrjes Park Entrance Drive dhe bregut të gjirit Gardiners Bay pësuan gërryerje serioze, e po kështu u dëmtuan edhe katër seksione të rrugës së asfaltuar (afro 650 metra). Dolën në sipërfaqe instalimet e nëndheshme në të gjithë hyrjen e makinave. Të gjitha ndërtesat e parkut u përmbytën. Valët e stuhisë fshinë pikën vrojtuese të lifeguard si dhe tavolinat e piknikut në breg. Pothuaj 31 pemë në hyrje dhe në zonën e piknikut u dëmtuan dhe/ose shkatërruan për shkak të valëve nga stuhia dhe përmbytjeve. Departamenti i Transportit po riparon rreth 650 metra, si dhe katër seksione të rrugës janë pastruar nga asfalti i dëmtuar dhe janë përgatitur për tu asfaltuar (po ta lejojë moti). DOT parashikon asfaltimin në dy javët e ardhme ndërkohë që ngrohet moti.

Të gjitha instalimet u futën përsëri nën tokë përgjatë korsisë rezervë në hyrje; janë riparuar linjat telefonike. Impianti i përpunimit të ujërave është riparuar dhe vënë në funksionim, klorinuesi është instaluar mbi zonën e përmbytjes. Janë ndërtuar dy skarpata përgjatë dy seksioneve të rrugës së gërryer për të mbrojtur rrugën e re. Janë përdorur mbi 4000 metër kub rërë/zhavorr për të restauruar një përforcues prej afro 22 metra për të mbrojtur kompleksin e ndërtesave. Kasollja e mirëmbajtjes është zëvendësuar, prizat elektrike janë zëvendësuar dhe furra është riparuar.

Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për riparimin.

Parku shtetëror Nissequogue River

Gjendja aktuale: Serës (Greenhouse) i ishin thyer 30 panele xhami në dy krahët. Humbën mbi 100 pemë të cilave u kishin dalë rrënjët ose ishin thyer. Në zonat e marinës, valët jashtëzakonisht të larta përmbytën ndërtesat përgjatë bregut. Zinxhiri, shtyllat dhe parmakët e gardhit u shkatërruan nga pemët

apo degët e rrëzuara. Shuma nga tabelat u thyen ose u dëmtuan në të gjithë parkun. Parku u rihap për publikun brenda një jave e gjysmë pas stuhisë. Vija bregdetare përgjatë lumit Nissequogue pësoi gërryerje të vogla.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për riparimin.

Parku historik shtetëror Planting Fields
Gjendja aktuale: Shumica e pjesëve të arboretum janë të hapura për publikun. Të gjitha pemët më të vogla janë hequr nga punonjësit e parkut. Heqja e pemëve më të mëdha, krasitja dhe pastrimi i mbi 100 pemëve që mbeten do të vazhdojë. Pritet që puna të përfundojë përpara fundit të prillit.
Dëmet e serës Camellia Greenhouse do të riparohen këtë pranverë. U instalua një çati e përkohshme për të siguruar mbrojtjen e koleksionit të serës. Shqyrtimi nga zyra për mbrojtjen e vlerave historike (State Historic Preservation Office) (SHPO) ka përfunduar; kontraktori po prodhon tani pjesët e reja të strukturës.
Është riparuar përkohësisht linja elektrike ajrore. Zëvendësuesja e qendrës informative që u shkatërrua është pastruar.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Pjesa e dëmtuar e seksionit të Camellia Greenhouse do të jetë duke u riparuar. Disa nga shtigjet dhe sera (Greenhouse) do të hapen.

Parku shtetëror Robert Moses
Gjendja aktuale: Parku shtetëror Robert Moses ka pësuar dëme të konsiderueshme. Ana jugore e rrethit të trafikut të parkut u fundos në oqeanin Atlantik, duke e mbyllur parkun qysh nga tetori. Restaurimi i rrugës po vazhdon. Shëtitorja në Field #5 u dëmtua rëndë. Po vazhdon kontrata për heqjen dhe restaurimin e komponentëve. Një çarje që kishte pësuar sistemi i ujit brenda parkut është riparuar në pjesën veriore të parkut. Departamenti i Shtetit për Ruajtjen e Mjedisit (State Department of Environmental Conservation) (DEC) ka miratuar zëvendësimin e materialeve prej guri për ta mbrojtur atë si dhe infrastrukturën tjetër që gjendet në anën e gjirit të Robert Moses. Janë bërë riparime të gardhit në të gjithë parkun. Shumë nga mbeturinat që dallgët i kishin hedhur në park janë mbledhur dhe stafi vazhdon të mbushë kazanët dhe t'i nxjerrë nga parku. Riparimet përfundimtare të fushës së golfit që u përmbyt do të fillojnë kur të hyjë stina e mbjelljeve. Nuk pritet që të ketë vonesa në golf kur të hapet parku në fund të majit. Qindra mijëra metër kub rërë u rrëmbyen nga stuhia. Dy kontraktorë kanë marrë përsipër pasurimin me rënë të Fields #4 dhe #5, fushat më lindore të parkut. Parashikohet që në këto plazhe të hidhet rreth 500,000 metër kub rërë. Rreth 300,000 metër kub rërë po nxirret nga kanali Captree State Boat Channel ndërsa 200,000 metër kub të tjera do të nxirren nga një grumbull rëre në qoshen perëndimore të parkut. Tri pika vrojtuese të lifeguard dhe pajisje të tjera të lifeguard do të duhet të zëvendësohen përpara fundjavës së Ditës Përkujtimore.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: Të gjitha fushat e parkingut do të jenë të HAPURA. Kapaciteti i parkingut mund të ulet në vartësi të hapësirës në dispozicion për plazhistët. Do të merret një vendim për aksesin e plazheve dhe notit përpara fundjavës së Ditës Përkujtimore, pasi të bëhet vlerësimi i rimbushjes me rërë. Parashikohet që nxjerrja e rërës do të vazhdojë deri në fund të qershorit. Në atë kohë, do të bëhet një rivlerësim tjetër për të përcaktuar aftësitë operuese.

Parku shtetëror Governor Alfred E.Smith/Sunken Meadow

Gjendja aktuale: Argjinatura në Field #3 ishte çarë. Një konsulent ka përfunduar dizenjimin e një ure dhe stabilizimin e vijës bregdetare. Është dhënë leja dhe State Parks po punojnë me DEC për të siguruar lejet e tyre. Rreth 400 ose 500 pemë të parkut ose ishin rrëzuar ose dëmtuar. Po vazhdon pastrimi. Pati dëmtime të zinxhirit, parmakëve, dhe gardheve në të gjithë parkun. Në plazhin perëndimor, pati gërryerje përgjatë brigjeve të rrëpirta; megjithatë u fitua pjesë bregdetare për shkak të stuhisë.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – me përjashtim të aksesit të pjesës lindore të parkut për shkak të çarjes së argjinaturës.

Parku shtetëror Valley Stream

Gjendja aktuale: Kontraktori i pemëve ka përfunduar gjithë punën me pemët me përjashtim të heqjes së mbeturinave nga parkingu. Shtigjet janë hapur. Në anën Hendrickson Ave të parkut, kanë mbetur trungje që duhen hequr dhe cungje që duhen grirë.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Në zona të parkut do të ketë ende mbeturina të pemëve dhe pemë të rrëzuara.

Parku shtetëror Wildwood

Gjendja aktuale: Parku shtetëror Wildwood pati dëme të konsiderueshme të pemëve. Në fushën e kampingut ka ende pemë të dëmtuara por po vazhdon puna. Pati gërryerje të bregdetit. Plazhi është ende i mbyllur për shkak të stuhisë. Rruga për në plazh është rrëmbyer nga uji dhe janë dëmtuar disi edhe banjat. Është dhënë një kontratë për këtë punë. Aktualisht, parku ka rihapur pothuaj të gjitha shtigjet dhe zonën e piknikut. Fusha e kampingut është hapur dhe shumica e pemëve të rrezikshme janë hequr. Po vazhdon puna për pastrimin e degëve dhe grumbujve të drurëve si dhe heqja e një numri të madh të cungjeve.
Gjendja në fundjavën e Ditës Përkujtimore: HAPUR – Do të vazhdojë puna për riparimin.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shteti i Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418